

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në vend, në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe në nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2025, për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjikë afatmesëm në këto drejtime:

Përparimin në përafrimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe statistikor me standardet e Bashkimit Evropian përmes hartimit dhe rishikimit të akteve kyçe për sistemin financiar, përfshirë projektligjin “Për institucionet e kreditit”, që forcon mandatin makroprudencial, si dhe nisjen e ndryshimeve në ligjin “Për shërbimet e pagesave” në përputhje me PSD2 dhe EMD2, duke avancuar konvergjencën institucionale, adresuar problematikat e subjekteve të mbikëqyrura, në mbështetje të integritetit evropian të sistemit financiar.

Rritjen e konkurrueshmërisë dhe modernizimit të tregut bankar, pasi pas një periudhe të gjatë stabiliteti me 11 banka, u dhanë miratimet për futjen e aktorëve të rinj në tregun bankar si “Jet Bank” dhe banka turke “Ziraat”, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt inovacionit dhe transformimit digjital të sektorit financiar në vend.

Integrimin e implikimeve që rrjedhin nga ndryshimet klimatike në funksionet kryesore të Bankës dhe në aktivitetin e sektorit bankar përmes avancimit të mbikëqyrjes prudenciale dhe përfshirjes së rreziqeve klimatike në proceset e menaxhimit të riskut, vlerësimit të ndikimit të tyre në stabilitetin financiar dhe në rezultatet e provave të rezistencës, si dhe zhvillimit të mjeteve analitike dhe aktiviteteve kërkimore në mbështetje të politikave të gjelbra. Gjithashtu, në bashkëpunim me Bankën Evropiane të Investimeve po punohet për hartimin e Taksonomisë së Gjelbër të Shqipërisë, me synim vendosjen e një kornize të harmonizuar për klasifikimin e aktiviteteve të qëndrueshme sipas standardeve të BE-së.

Forcimin e kuadrit makroprudencial, me fokus frenimin e rreziqeve që mund të ndikojnë sistemin financiar, përmes ruajtjes së kërkesave ekzistuese të kapitalit dhe vendosjes për herë të parë të kufijve mbi raportet e huamarrjes për pasuritë e paluajtshme rezidenciale, ku zbatimi konkret i këtyre masave u realizua përmes shtesës konservuese të kapitalit në nivelin 2.5%, aplikimit të shtesës për bankat me rëndësi sistematike në intervalin 0.5–1% dhe rritjes graduale të shtesës kundërciklike të kapitalit nga 0 në 0.5%, duke kontribuar në moderimin e rritjes së kredisë, parandalimin e akumulimit të rreziqeve sistematike dhe forcimin e aftësisë së bankave për të përballuar periudhat e ngadalësimit të aktivitetit financiar, në funksion të një sektori bankar më të qëndrueshëm dhe rezilient.

Përmirësimin e kuadrit rregullator për mbrojtjen e konsumatorit, në përgjigje të sfidave të viteve të fundit, përmes forcimit të kërkesave për transparencë dhe informim për produktet dhe shërbimet financiare, duke siguruar qartësi më të madhe për normat e interesit, kostot, komisionet dhe kushtet kontraktuale, si dhe orientimin e subjekteve drejt një komunikimi më të thjeshtë, të unifikuar dhe të kuptueshëm, çka kontribuon në kufizimin e praktikave të padrejta dhe në funksionimin më të qëndrueshëm dhe transparent të tregut financiar.

Mbështetjen e biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm përmes Programit të Financimit BVM, një instrument strategjik që synon të rrisë aksesin në kredi, të nxisë investimet dhe të modernizojë kapacitetet prodhuese në sektorë kyç si industria, tregtia dhe bujqësia, përmes normave të favorshme të interesit dhe strukturave afatgjata të financimit, zbatimi i të cilit nisi në 3-mujorin e dytë të vitit 2025 dhe ka dhënë rezultatet e para me 131 kredi të akorduara me një vlerë totale prej rreth 1.8 miliardë lekësh ose rreth 7.2% e fondit të përgjithshëm.

Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe monitorimit të riskut në sektorin financiar nëpërmjet realizimit të 10 ekzaminimeve të plota në 3 banka, 3 SFJB, 2 institucione të parasë elektronike dhe 2 SHKK, si dhe 2 ekzaminimeve të pjesshme në 1 bankë dhe 1 SFJB, ku për shkeljet dhe mangësitë e evidentuara u ndërmorën masa konkrete mbikëqyrëse, përfshirë gjobitjen e 2 institucioneve të parasë elektronike, pezullimin e aktivitetit për 1 SFJB dhe revokimin e licencave për 1 SHKK, 2 SFJB dhe 1 institucion pagese, ndërsa procesi i inspektimeve në 26 zyra të këmbimit valutor, përfshirë një inspektim të përbashkët me AIF-në, rezultoi në marrjen e rreth 200 masave administrative dhe në disa raste në heqjen e licencave.

Fuqizimin e aftësisë së bankave për zbatimin e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme përmes avancimit të kuadrit rregullator për instrumentet e kapitalit (MREL) dhe operacionalizimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili arriti në 7.02 miliardë lekë pas kontributit vjetor prej 1.041 miliardë lekësh nga të gjitha bankat, si dhe realizimit të inspektimeve vjetore, përgatitjes së dokumenteve udhëzuese për zbatimin e instrumenteve të rikapitalizimit nga brenda dhe të instrumentit të bankës urë dhe nisjes së rishikimit të kuadrit ligjor dhe metodologjik për përafrimin e tij me standardet e BE-së.

Modernizimin e ekosistemit të pagesave përmes përmirësimit të kuadrit rregullator dhe infrastrukturës për transferta elektronike, përfshirë përditësimin e sistemeve sipas standardit ISO 20022, rishikimin e tarifave për pagesa në lek dhe euro, si dhe operacionalizimin e transfertave SEPA që nisën më 7 tetor 2025, duke mundësuar pagesa pa komision deri në 40.000 lekë, tarifa 0.005% për pagesat deri në 10 milionë lekë dhe një maksimum prej 750 lekësh për vlera më të larta, si dhe tarifa të reduktuara për pagesat në euro deri në 0.01% dhe maksimum 25 euro, duke kontribuar kështu në uljen e kostove dhe rritjen e përdorimit të pagesave elektronike.

Garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të infrastrukturave kryesore të pagesave dhe shlyerjes së titujve:

Sistemi AIPS: likuiditeti i qarkulluar arriti në 14 610 miliardë lekë ose rreth 5.5 herë PBB-në, ndërsa transaksionet u rritën me 0.8%.

Sistemi AIPS euro: u procesuan 398 757 transaksione me vlerë 6 329.4 milionë euro, me rritje 23% në numër dhe 21% në vlerë.

Sistemi AECH: kufiri i pagesave u rrit gati 7-fish dhe komisionet për pagesat deri në 40 mijë lekë u eliminuan, duke çuar në 40% pjesëmarrje të pagesave elektronike në total nga 27% në 2020.

Sistemi AFISaR: funksionoi me 14 institucione, ndërsa llogaritë e individëve arritën në 20,009 dhe vlera e titujve të shtetit mbi 838 trilion lekë, me rritje 6.29%.

Zgjerimin e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, ku gjatë vitit u realizuan 59.2 milionë pagesa me vlerë 7595 miliardë lekë, me rritje 22.7% në numër dhe 17.9% në vlerë:

Pagesat elektronike arritën në 53 milionë transaksione me vlerë 3.187 miliardë lekë, me rritje 26% dhe 14%.

Home Banking përfaqësoi 46.8% të llogarive dhe u rrit me 23.2% në numër dhe 14.5% në vlerë.

Kartat aktive arritën mbi 1.65 milionë, ndërsa përdorimi në POS u rrit me 38.7% në numër dhe 26.9% në vlerë, me zgjerim të infrastrukturës POS dhe ATM.

Nxitjen e inovacionit, përfshirë fillimin e operacionalizimit të *banking*-ut të hapur nga dy banka, duke u mundësuar klientëve akses në të dhënat e llogarive dhe kryerjen e pagesave përmes ofruesve të palëve të treta, si dhe avancimin e projektit TIPS Clone për krijimin e një sistemi rajonal të pagesave të menjëhershme, i cili pritet të përfundojë në vitin 2026, duke kontribuar në rritjen e shpejtësisë dhe sigurisë së pagesave elektronike.

Forcimin e rrjeteve të kontrollit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes përmirësimit të kuadrit mbikëqyrës dhe kriterëve të licencimit për zyrat e këmbimit valutor, rritjes së kontroleve dhe cilësisë së raportimit, si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht me AIF-në, në funksion të vlerësimit ndërkombëtar të vitit 2026.

Akomodimin e kërkesës për *cash* në ekonomi përmes përfundimit të emetimit të plotë të serisë së re të kartëmonedhave dhe garantimit të qarkullimit cilësor dhe të sigurt, ku monedha në qarkullim arriti rreth 504 miliardë lekë, me rritje prej 14.3% krahasuar me vitin 2024.

Menaxhimin e rezervës valutore që arriti në 7305.5 milionë euro, me rritje vjetore prej 16.5%, duke reflektuar një strukturë të diversifikuar me dominancë të euros dhe dollarit.

Përmbushjen e një detyrimi të rëndësishëm në kuadër të kapitullit 18 të *acquis* të Bashkimit Evropian përmes transmetimit për herë të parë pranë Eurostat-it të Bilancit Mujor të Pagesave, duke avancuar harmonizimin e statistikave kombëtare me standardet e Bashkimit Evropian.

Kuvendi rekomandon që Banka e Shqipërisë për vitin 2026 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të ndërmarrë nismat e nevojshme për përafrimin e mëtejshëm të ligjit organik të Bankës së Shqipërisë me kërkesat e progresraportit dhe *acquis*-n e Bashkimit Evropian, veçanërisht në drejtim të garantimit të plotë të pavarësisë institucionale, forcimit të mekanizmave që sigurojnë ndalimin e financimit monetar të sektorit publik dhe eliminimin e çdo forme të aksesit të privilegjuar.

2. Të përshpejtojë përmbylljen e procesit të përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator bankar me *acquis*-n e Bashkimit Evropian përmes përgatitjes së ligjit të ri për institucionet e kreditit, përditësimin të kuadrit për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave, rishikimit të ligjit për sigurimin e depozitave dhe akteve nënligjore përkatëse, duke adresuar në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare boshllëqet në mbikëqyrjen e konglomerateve financiare dhe duke kontribuar në rritjen graduale të financimit të Fondit të Zgjidhjes deri në nivelin 1% të depozitave të mbuluara.

3. Të vijojë forcimin e kuadrit analitik të politikës monetare përmes pasurimit të modeleve makroekonomike dhe përfshirjes më të plotë të faktorëve strukturorë të ekonomisë, si zhvillimet në tregun e punës, demografia, kursi i këmbimit, me qëllim rritjen e saktësisë së parashikimeve, përmirësimin e kalibrit të vendimmarrjes dhe dallimin më të qartë midis faktorëve kalimtarë dhe atyre me ndikim të qëndrueshëm.

4. Të zbatojë një qasje të kujdesshme ndaj ecurisë së kursit të këmbimit, duke respektuar regjimin fleksibël të kursit të këmbimit në vend si amortizues i goditjeve të jashtme dhe duke kufizuar ndërhyrjet në tregun valutor vetëm në rastet kur këto ndërhyrje konsiderohen të nevojshme për rritjen e rezervës valutore, për funksionimin normal të tregut valutor ose për ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar të vendit.

5. Të forcojë më tej mbikëqyrjen prudenciale ndaj bankave me përqendrim të lartë të ekspozimeve ndaj huamarrësve të mëdhenj, sektorit publik dhe kreditimit në sektorin e pasurive të paluajtshme, duke vlerësuar në mënyrë të posaçme ndërveprimin e këtyre rreziqeve, si dhe të kufizojë ndërmarrjen e ndryshimeve rregullatore preferenciale për financimin e sektorëve specifikë, si projektet infrastrukturore në transportin rrugor, portual dhe aeroportual, të cilat mund të rrisin ndjeshmërinë e sistemit ndaj goditjeve në rast të mosrealizimit të këtyre investimeve.

6. Të sigurojë një tranzicion të qëndrueshëm të sektorit bankar drejt zbatimit të standardit IFRS 9, duke garantuar që deri në hyrjen në fuqi të tij, në fillim të vitit 2027, të jenë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë ndjekjen e marrëveshjeve tranzitore, krijimin e rezervave prudenciale për provigjionet, vlerësimin e hershëm dhe të vazhdueshëm të ndikimit mbi kapitalin dhe përfitueshmërinë, si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve të nevojshme njerëzore dhe teknike.

7. Të përshpejtojë rishikimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe akteve nënligjore përkatëse, në mënyrë që përafrimi me PSD2, EMD2 dhe kuadrin evropian për transparencën dhe pagesat ndërkufitare të përmbyllet në kohë, si dhe paralelisht të sigurojë përfundimin brenda vitit 2026 të sistemit TIPS Clone dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së pagesave, në funksion të zgjerimit të aksesit në pagesa në kohë reale për individët dhe bizneset, si dhe rritjes së efikasitetit dhe sigurisë së sistemit të pagesave.

8. Të përfundojë dhe të zbatojë në mënyrë të plotë kuadrin për qëndrueshmërinë operationale digjitale dhe rrezikun kibernetik, përfshirë miratimin e rregullores së re të përafruar me DORA, testimet periodike të sigurisë për bankat sistemike dhe forcimin e protokolleve të reagimit ndërinstitutional ndaj incidenteve kibernetike, në mënyrë që modernizimi i shërbimeve financiare të shoqërohet me rritje proporcionale të reziliencës operationale.

9. Të avancojë më tej kuadrin rregullator për financimin e qëndrueshëm dhe integrimin e rreziqeve klimatike në sektorin bankar, përmes përfundimit të Taksonomisë së Gjelbër dhe hartimit të Strategjisë përkatëse, si dhe të sigurojë zbatimin gradual të këtij kuadri në praktikën mbikëqyrëse,

përmes zhvillimit të metodologjive të matjes, përmirësimit të raportimit dhe përfshirjes së këtyre rreziqeve në vlerësimin e kapitalit dhe analizat e stresit.

10. Të avancojë zbatimin praktik të *open banking* në sektorin bankar, duke siguruar mbikëqyrjen efektive të përdorimit nga institucionet financiare, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e ofruesve të shërbimeve financiare të palëve të treta, në funksion të rritjes së konkurrencës, inovacionit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

11. Të ushtrojë një mbikëqyrje të shtuar dhe të vazhdueshme në fazën fillestare të ushtrimit të veprimtarisë së bankave të reja të licencuara, veçanërisht për ato me model plotësisht digjital, duke siguruar që funksionimi i tyre të jetë në përputhje të plotë me kërkesat rregullatore, standardet e sigurisë kibernetike, mbrojtjen e konsumatorit dhe menaxhimin e rreziqeve operacionale, në mënyrë që hyrja e tyre në treg të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme në rritjen e konkurrencës dhe stabilitetit financiar.

12. Të monitorojë nga afër zbatimin nga bankat e nivelit të dytë të Programit të Financimit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, përfshirë skemën e garancisë sovrane, duke vlerësuar ritmin e disburimit të kredive, aksesin efektiv të bizneseve në financim, respektimin e kushteve të programit, shpërndarjen sektoriale të kredive dhe pengesat që kufizojnë përdorimin e këtij instrumenti, të raportojë periodikisht për rezultatet e monitorimit, si dhe të propozojë masat e nevojshme për rritjen e efektivitetit të tij.

13. Të ndjekë dhe të vlerësojë zhvillimet institucionale, rregullatore dhe prudenciale që lidhen me Bankën Shqiptare të Zhvillimit dhe në koordinim me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave të ndërmarrë masat e nevojshme mbikëqyrëse dhe rregullatore në rast se veprimtaria e këtij institucioni do të përfshijë pranimin e depozitave.

14. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi